



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk.II.nr.85/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përbarimore të kreditorit të përbarimit “Limi L&B” ShPK me seli në rrugën Xheladin Hana nr. 20 në Prizren, i cili përfaqësohet nga avokati Betim Kadolli me seli në rrugën William Walker në Prizren, kundër debitorit të përbarimit “Lake Side Ag” ShPK me seli në fshatin Vërmicë të Prizrenit, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit dhe debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1536/22 të datës 29.09.2023, me datë 07.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Limi L&B” ShPK si dhe ankesa e debitorit “Lake Side Ag” ShPK ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1536/22 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1536/22 të datës 29.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit të përbarimit “Lake Side Ag” ShPK me seli në Prizren, ndërsa ka anuluar pjesërisht urdhrin përbarimor P.nr.192/2022 i datës 20.04.2022 i përbaruesit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren lidhur me shumën e prej 52,035.00€, dhe është përfunduar pjesërisht procedura përbarimore lidhur me këtë pjesë. Në pjesën e II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit të përbarimit “Lake Side Ag” ShPK me seli në Prizren, dhe ka

lënë në fuqi pjesërisht urdhrin përmbarrimor P.nr.192/2022 i datës 20.04.2022 i përmbarruesit privat Rushit Hoxha me seli në Prizren lidhur me pjesën tjetër të kërkesë në shumë prej 20,610.75€.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1536/22 të datës 29.09.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Kundër aktvendimit ankesë brenda afatit ligjor ka parashtruar edhe debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1536/22 të datës 29.09.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit dhe e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Limi L&B” ShPK ka paraqitur propozimin për përmbarrim me të cilin kërkuar që të detyrohet debitori i përmbarrimit “Lake Side Ag” ShPK me seli në Prizren (këtu e tutje Debitori) t’ia paguaj shumën prej 72,645.75€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore. Propozimin për përmbarrim e kishte bazuar në faturat me numrat dhe datat si në vijim: nr.03/2019 LS e datës. 25.12.2019 në lartësi prej 1,143.00€, nr.04/2019 LS e datës. 25.12.2019 në lartësi prej 7,967.25€, nr.05/2019 LS e datës 27.12.2019 në lartësi prej 61,500.00€, nr.05/20 LS e datës 05.10.2020 në lartësi prej 45,430.00€ dhe nr.06/20 LS e datës 05.10.2020 në lartësi prej 6,605.50€ të lëshuara nga Kreditorit për Debitorin, të cilat në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. Kreditori gjithashtu ia ka bashkëngjitur Propozimit deklaratën lidhur me kërkueshmërinë dhe afatin e pagesës. Përmbarruesi më 20.04.2022 e ka nxjerrë urdhrin përmbarrimor P.nr.192/2022 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbarrimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri).

Debitori më 06.05.2022 ka parashtruar prapësim (këtu e tutje Prapësimi) duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarrimor dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj urdhrin përmbarrimor, si dhe që këtë lëndë ta referoj në procedurë përmbarrimore. Ai ka pretenduar se faturat nr.05/20 LS e datës

05.10.2020 në lartësi prej 45,430.00€ dhe nr.06/20 LS e datës 05.10.2020 në lartësi prej 6,605.50€ nuk janë dokumente të besueshme, meqë ato nuk janë nënshkruar e as të vulosura nga ai. Debitori ka shtuar se Propozimi është në kundërshtim me kontratën për furnizim, punë e shërbime të datës 20.06.2019, meqë kjo marrëveshje është lidhur ndërmjet Kreditorit dhe “BluePlan Kosovo AG” ShPK, që paraqet subjekt tjetër juridik. Në këtë drejtim ka sqaruar se faturat nr.03/2019 LS e datës 25.12.2019 në lartësi prej 1,143.00€, nr.04/2019 LS e datës 25.12.2019 në lartësi prej 7,967.25€ janë pjesë e asaj kontrate dhe nuk janë pranuar nga ai. Ngjashëm ka deklaruar edhe për faturën nr.05/2019 LS të datës 27.12.2019 në lartësi prej 61,500.00€. Sipas Debitorit, ai i ka kryer Kreditorit pagesën në shumën e përgjithshme prej 160,00.00€, që paraqet 80% të vlerës së kontratës, ndonëse Kreditori nuk i është përmbajtur kontratës, gjegjësisht nenit 4 të saj. Përveç kësaj, ai ka shtuar se shuma e kërkuar me Propozim e kalon shumën totale prej 200,000.00€ të caktuar me kontratë nga palët. Prapësimi ia ka bashkëngjitur në kopje kontratën për furnizim, punë dhe shërbime të datës 20.06.2019 të lidhur ndërmjet Kreditorit dhe “BluePlan Kosovo AG” ShPK, listën e transaksioneve bankare na xhirollogaria e tij lidhur me transferet bankare ndaj Kreditorit dhe një urdhërpagesë në formë paragonit të datës 09.07.2019. E ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me prapësimin.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin. Ai ka pretenduar se faturat lëndore i janë dërguar Debitorit përmes postës elektronike, meqë kishin bashkëpunim të gjatë mes vete. Ndërkaq pranimin e faturave lëndore e vërteton fakti se ato janë deklaruar në ATK si nga Kreditori ashtu edhe nga Debitori, në të kundërtën nuk kanë mundur të deklarohen në ATK. Në këtë drejtim ka shtuar se, Debitori asnjëherë nuk i ka kundërshtuar faturat lëndore ose obligimin që rrjedhë nga atë. Për fund ka potencuar se Prapësimi i Debitorit ka për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës. Përgjigjes në prapësim ia ka bashkëngjitur në kopje librin e tij të shitjes për periudhën kohore 01.10.2020 – 31.10.2020, listën e shitjeve të Kreditorit të tatueshme me normë 18% nga data 13.05.2019 – 02.12.2019 dhe 07.09.2020-03.08.2020, listat me mbishkrimin “Limit Kartela Analitike prej 01.01.19 deri: 31.12.19” dhe “Limit Kartela Analitike prej 01.01.20 deri: 31.12.20” mbi të cilën me dorë është shënuar me dorëshkrim të cilat sipas Kreditorit janë lëshuar nga njësia e hetimeve në ATK, si dhe dërgimet elektronike nga Kreditori te Debitori të datës 01.04.2020 dhe 17.11.2020. E ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me përgjigjen në prapësim

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1536/22 të datës 29.09.2023, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata erdhi në përfundim se faturat nr.05/20 LS e datës 05.10.2020 në lartësi prej 45,430.00€ dhe nr.06/20 LS e datës 05.10.2020 në lartësi prej 6,605.50€ nuk janë të nënshkruara nga Debitori, që nënkupton se ato nuk janë pranuar nga Debitori. Gjykata gjithashtu vëren se nuk ka asnjë provë nga të cilat do të provohej se Debitori i ka pranuar këto fatura në ndonjë mënyrë tjetër andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit. Ndërsa, Gjykata konstatoi se faturat tjera lëndore në bazë të cilave është lejuar përmbartimi i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, edhe për faktin se ato janë pranuar nga Debitori, që për gjykatën nënkupton se detyrimi që rrjedhë nga ato është pranuar nga ai, rrjedhimisht gjykata e pranoi si të drejtë caktimin e përmbartimit në bazë të këtyre faturave. Përveç kësaj, Kreditori nuk ka paraqitur asnjë provë nga e cila rrjedhe se faturat kanë humbur efektin juridike, siç e ka për obligim nga neni 69 para. 5 i LPP-së. Prandaj gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke anuluar pjesërisht prapësimin e debitorit ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se faturat nr.05/20 LS e datës 05.10.2020 në lartësi prej 45,430.00€ dhe nr.06/20 LS e datës 05.10.2020 në lartësi prej 6,605.50€ nuk janë të nënshkruara nga Debitori, që nënkupton se ato nuk janë pranuar nga Debitori.

Gjykata e shkallës së dytë është bazuar në nenin 29 të LPP-së, i cili në para. 1 nënpara. 3 ka rregulluar se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është (...) 1.3 faturat” ndërsa në para. 3 ka paraparë se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Ndërsa me Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është disponues për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se faturat nr.03/2019 LS e datës. 25.12.2019 në lartësi prej 1,143.00€, nr.04/2019 LS e datës. 25.12.2019 në lartësi prej 7,967.25€, nr.05/2019 LS e datës 27.12.2019 në lartësi prej 61,500.00€, në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se janë pranuar nga debitori, të njëjtat janë të vulosura nga debitori në mënyrë që të konsiderohen si dokumente të besueshme. Në këto fatura janë të dhënat e Debitorit, nënshkrimi dhe vula e Debitorit si dhe pikërisht Debitori e ka bërë pagesën e pjesëshme të faturës 05/2019 LS të datës 27.12.2019. Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit dhe të debitorit në ankesë por të njëjta mbesin të pabazuara pasi nuk kanë arritur të argumentojnë me prova juridikisht të vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.Shk II.nr.85/24 me datë 07.06.2024

Gjyqtari ,

Faton Bajrami